

Karavani - Ibrahim

„Engjulli i Kulturave“

Akcioni i artit si pjesë e kryeqyteteve kulturore Evropiane në vitin 2010



Ruhr.2010, Peç.2010, Istanbul.2010
prej 3. Maj deri më 31. Maj 2010

Për çfarë bëhet fjalë tek „Engel der Kulturen“ Engjulli i kulturave

Engjulli i Kulturave është një projekt arti i artistëve vizual Dietrich Carmen dhe Gregor Merten. Kjo vë në vepër artistike, pikturale dhe në lidhje me akcionet publike për atë që shumë njerëz dhe grupe në shoqëri – dhe në fe angazhohen; për respekt, tolerancë, bashkjetesë dhe bashkupunim në integrimin e suksesshëm. Kjo pikturë **Engjulli i Kulturave**, për nga brenda e hapur, me yllin e Davidit, kryqin dhe gjysëm hënën e mbajtur në rrotë, lidhur në kontur të brendshëm – pa qëllim (rastësisht) – është formësues i një engjulli. Ky projekt shpalosë në forma të ndryshme art - dhe aktivitete edukative të mrekullueshme me efekt në hapsirën publike.

Për çfarë bëhet fjalë tek Karavani Ibrahim Engjulli i kulturave, ngjarje arti si pjesë e kryeqyteteve kulturore të Evropës në vitin 2010

Prej 2 deri më 31 Maj **Karavani Ibrahim „Engjulli i kulturave**, do të kalojë nëpër kryeqytetet kulturore të Evropës , duke lëvizur fleksibël gjithmonë i përfaqësuar publikisht, nga zona e Ruhr (Essen) e në Peç të Hungarisë, dhe në Stamboll të Turqisë dhe do të kthehet prapa.

Në rrugën e saj mes tre kryeqyteteve Evropiane të kulturës zonës së **Ruhrit, Peçit dhe Stambollit karavani Ibrahim Engjulli i kulturave** përmes aktiviteteve të artit ka për qëllim të aktivizoj njerëz, të krijoj lidhje, rrjetet e vendosura ti thellojë dhe të vë impulse me efekt të qëndrueshëm.

Rruga përmes Evropës qendrore/lindore dhe Ballkanit çon nëpërmjet shumë vendeve zonave që kanë një të kaluar shumë të llojllojshme dhe kujtime komplekse, vende ndërkultore, ura ndërfetare dhe për ndërtim të bashkjetesës dhe bashkveprimit të frytshëm me njëri tjetrin, poashtu edhe lufta vdekjeprurëse – së fundi në vitet e 90ta.

Ibrahimi është bërë një simbol respekti, mirëkuptimi dhe bashkjëtesë mes hebrenjëve, krishterëve dhe muslimanëve në shumë vende si në Evropë dhe në kontinente tjera. Ibrahimi në judizëm, krishterizëm dhe në islam respektohet si një paraardhës i detyrueshëm. Kështu Ibrahimi është për kohën tonë një urë e fortë për dialog dhe figurë frymëzuese për njohjen dhe të kuptuarit e unitetit në vend të intolerancës, urrejtjes, përjashtimit, dhe dhunës. Gjithashtu në zonën e Ruhrit është Ibrahimi në vende të ndryshme aktual dhe prezent, p. sh. në **Festën e Ibrahimit** në Marl (rethi Recklinghausenit) që nga vjeshta e 2001.

Si duken akcionet e Artit të Engjullit të kulturave?

1. Krijim i pikturës së përkohshme me rërë

Skulptura e **Engjullit të kulturave** vendoset në sipërfaqe në mënyrë anësore dhe brendia mbushet me rërë „quarci“ të bardhë dhe pastaj me ndihmën e magneteve të rënda mënjanohet skulptura.



Më 9. Nëntor 2008 70 vjetorin e natës së kristallit artistët e kanë lidhur simbolikisht në katedralen e Kölnit (Kolis), Sinagogës dhe Xhamisë me njëra tjetrën duke vënë me skulpturën e çelikut të Engjullit të kulturave prej një shpie të Zotit tek tjetra duke lënë një pikturë të përkohshme rëre me brendinë e figurës.

Rëra e këtyre pikturave mblidhet dhe në akcionet tjera të këtij lloji gjithmonë ripërdoret.

2. Instalacioni i përhershëm në pllakë

Këtu **Engjulli i kulturave** në formë të një rrethi nga çeliku, betoni special me ngjyrë blu me një kornizë alumini përforcohet për toke. Kjo shenjë e qëndrueshme vendoset në shkolla dhe në objekte tjera publike.



Në Gjermani, veçanërisht në kontekstin e Ruhr 2010 bënë këtë në një proces më të plotë ku të pranishmit mund të marrin pjesë përmes angazhimit të përbashkët me artistët në zjarr-prejren e shenjës për vendin tjetër.

Ky akcion i këtij arti tashmë është realizuar disa herë, kryesisht në shkolla të UNESCOs në zonën e Ruhrit.

Shiqo edhe në;

www.engel-der-kulturen.de

Ata çka dalin nga zjarr-prerja e brendis së **engjullit** mblidhen dhe shtresohen kështu që gradualisht të përbëhet e ashtuquajtura **Shtylla e Ibrahimit**, që preferohet mundsisht një her në **Jeruzalem** te ngritet.

Çfar qëllimi ka projekti i artit Engjulli i kulturave?

Në pjesmarrjen e akcionit të artit për fëmijët, adoleshentët dhe të riturit gjithmonë kuptojn se askush dhe asnjë grup nuk mund të ndahet dhe të largohet, nga rrethi pa dëm të përhershëm për të ardhmen e përbashkët. Sikur të mbetet në mendje dhe në të njëjtën kohë është gjithashtu një shenjë e kulturave kundër ekstremizmit të djathtë, fanatizmit dhe përjashtimit të të tjerëve dhe nxit integrimin e suksesshëm dhe të jetës së përbashkët në dinjitet dhe në diversitet.



Në Maj 2009 engjulli i kulturave u vu në lëvizje në këmbë duke u shty me dorë nga Kölni (Kolonja) për në Essen dhe në këtë rrugë ai bëri shumë stacione në vende të ndryshme ku pati edhe pjesmarje të lartë nga publiku në vënien mostrave të gjurmëve të rërës.

Sie do të duket Karavani i Ibrahimit Engjulli i kulturave?

Në maj 2010 projekt arti **Engjulli i kulturave** do të udhëtojë prej Essenit Ruhr 2010 si një karavan i motorizuar përmes rajonit të Evropës lindore në Stamboll. Në këtë mënyrë ai do të jetë në qytetet: e Augsburgit(Gjermani), Peç(Hungari), në Tuzla dhe Sarajevë(Bosnje dhe Hercegovinë), Kralevë(Serbi), Shkup(Maqedoni), Stamboll(Turqi) dhe në kthim: në Sofje(Bullgari), Dubica dhe Banja Luka(Bosnje dhe Hercegovinë), Në pothuajse të gjitha këta qytete, duhet të zbatohet si **piktura të përkohshme** me rërë si dhe ajo e **qëndrueshem në pllakë**. Në stacionet e vendqëndrimeve me kohë të shkurtëra, aktiviteti akcionit **engjulli i kulturave** do të përqendrohet me skulpturen e rethit rotullues mundësisht para shtëpive të Zotit të feve të ndryshme.



Çka duhet të arrihet me karavanin e Ibrahimit Engjulli i kulturave?

Kështu dëshirojmë që të arrijmë tek njerëzit e të gjithë gjeneratave, kulturave, feve, pasardhësve, poashtu edhe vetë ata ti aktivizojmë-kështu shpresojmë ne. Do të realizohen kontakte të lidhjeve të ndryshme përmes të cilave do të depërtoj edhe mesazhi i Engjullit të kulturave.

Nga një kryeqytet të kulturës në tjetrin,
nga një vendë fqinjë në tjetrin,
nga hebrenjët, krishterët dhe muslimanët,
nga vendet me mitet dhe thesaret e tyre, nga kujtimet e tyre me plagë
dhe „kohën e Artë“.

Për të lënë gjurmë komunikimi dhe të paqës.
Për të vënë shenjë edhe në vende dhe zona ku para disa vitesh anëtarë
të feve, popujve të ndryshëm në mënyrë reciproke janë ndjekur, vrarë
dhe kanë shkatëruar vende të adhurimit (shtëpi të Zotit).
Qëllimi është që në këtë pikpamje duke kaluar kufijt me projektin e artit
Engjulli i kulturave, njerëzit të inkurajojmë në ndërgjegjen e tyre për
unitet dhe veprimin e tyre të përbashkët tua forcojmë.
Nëpërmjet kësaj fotoje të thjeshtë dhe të qartë, ju bëhet me dije se
fqinjësia e mirë dhe jeta paqësore së bashku me njëri tjetrin alternative
tjetër nuk kanë, si tash poashtu edhe në të ardhmën.

Ne jetojm në një botë.

**Ne çelim zemrën njëri tjetrit dhe japim mundësi në mënyrë
reciproke për zhvillim.**


**Ne jemi me njëri tjetrin të lidhur dhe vetëm sëbashku dhe në
paqë mundë ta ndërtojmë të ardhmen.**

Shpjegimi termit të skulpturës sociale:

Tek Engjulli i kulturave bëhet fjalë për një art projekt në shkallë të gjërë, që në një shoqëri pruraliste bën të jetë me ndikim transformues.



Kjo qasje artistike është e njohur edhe si skulpturë sociale brenda kuptimit të konceptit të zgjeruar të artit nga Joseph Beuys, që kërkon veprim të njeriut në strukturim. Porjekti engjulli i kulturave kërkon të strukturoj e të shënoi një ndryshim në një lidhshmri të orientuar drejt një pamje të botës dhe kushdo që kontribuon në të, bëhet artist dhe një formues i shoqëris.



Projektimi i shenjave dhe idetë e projektit:
Atelier Gregori Merten dhe Carmen Dietrich
www.engel-der-kulturen.de

Organizatorë dhe pjesmarës në Karvanin Abrahamit:
Atelier Gregor Merten dhe Carmen Dietrich, Kamal Darwich,
Hartmut Dreier, Agnes Eroglu, Gunter Graf, Rudi Löffelsend,
Willi Overbeck